“Ai që i ka këto katër tipare është hipokrit i kulluar. Ndërkaq, ai që ka vetëm njërin prej tyre, ka një prej tipareve të hipokrizisë, derisa ta braktisë atë. Ato janë: kur flet, gënjen; kur bën marrëveshje, tradhton; kur premton, nuk e mban premtimin, si dhe kur polemizon, bëhet i pasjellshëm

Abdullah ibën Amri (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) tregon se i Dërguari i Allahut ka thënë: “Ai që i ka këto katër tipare është hipokrit i kulluar. Ndërkaq, ai që ka vetëm njërin prej tyre, ka një prej tipareve të hipokrizisë, derisa ta braktisë atë. Ato janë: kur flet, gënjen; kur bën marrëveshje, tradhton; kur premton, nuk e mban premtimin, si dhe kur polemizon, bëhet i pasjellshëm."

[Sahih] [Muttefek alejhi]

Profeti në këtë hadith ka paralajmëruar për katër tipare, të cilat, nëse bashkohen te një musliman, do t'u shëmbëllente shumë hipokritëve, për shkak të këtyre tipareve. Kjo vlen për ata te të cilët mbizotërojnë këto tipare. E, sa u përket atyre te të cilët këto tipare janë të rralla, nuk përfshihen në këtë hadith. Këto tipare janë: E para: kur flet, qëllimisht gënjen dhe nuk thotë të vërtetën në bisedim. E dyta: kur bën një marrëveshje, nuk e përmbush atë dhe e tradhton personin me të cilin ka bërë marrëveshje. E treta: kur premton, nuk e përmbush premtimin dhe nuk e mban atë. E katërta: nëse polemizon dhe grindet me dikë, bëhet i ashpër dhe mënjanohet nga e vërteta; tregohet dinak në refuzimin dhe zhvlerësimin e së vërtetës dhe thotë të pavërteta e gënjeshtra. Hipokrizia është shfaqja e së kundërtës së asaj që e fsheh. Ky kuptim është i pranishëm te njeriu që i ka këto tipare. Hipokrizia e tij vlen për atë njeri me të cilin flet, me atë që i premton, me atë që bën marrëveshje dhe me atë që polemizon, e jo se ai është hipokrit në Islam, në kuptimin që shfaq Islamin dhe fsheh kufrin (mosbesimin). Ndërkaq, ai që ka njërin nga këto tipare, ka një tipar të hipokrizisë, derisa ta braktis atë.

http://sunnah.global/hadeeth/sq/show/65124